



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 3669 Prot.

Tiranë, më 02.04. 2019

URDHËR

Nr. 202, datë 02.04. 2019

PËR  
LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË BORDIT  
TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR  
DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARËVE TË RINJ, PËRFAQËSUES TË  
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 48, 49 dhe 50 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë",

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarëve të Bordit të Administrimit, të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si më poshtë:
  - a) Lindita Rova;
  - b) Ismail Zeko;
  - c) Olise Kote.
2. Emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit të Administrimit, të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si më poshtë:
  - a) Maksim Hoxha;
  - b) Dorina Mastora;
  - c) Ermelinda Kordha.
3. Z. Artemis Malo, vijon si anëtar në Bordin e Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, deri në zgjedhjen e anëtarit përfaqësues të studentëve të këtij universiteti.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe anëtarët e Bordit të Administrimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
*Besa SHAHINI*  
Besa SHAHINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 5977 Prot.

Tiranë, më 07.06, 2019

URDHËR

Nr. 325, datë 07.6. 2019

PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 202, DATË 02.04.2019  
“PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË BORDIT  
TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”. GJIROKASTËR  
DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARËVE TË RINJ, PËRFAQËSUES TË  
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 48, 49 dhe 50 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 2 të urdhrit, nr. 202, datë 02.04.2019, të shtohet shkronja “ç”, si më poshtë:

“ç) Erjon Nebiaj”

2. Pika 3 e urdhrit, nr. 202, datë 02.04.2019, shfuqizohet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë dhe anëtarët e Bordit të Administrimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Besa SHAHINI

